



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

---

Nr. 71/1 Prot.

Tiranë, më 14/12/2011

**Lënda:** Rekomandim për *Klinika-Gjinekologjike "URSULA"*.

**REKOMANDIM**

Nr. 71/1, datë 14/12/2011

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, *Klinika-Gjinekologjike "URSULA"*,

**KONSTATOVA**

Më datë 11/11/2011, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, *Klinika-Gjinekologjike "URSULA"*, Tiranë, me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

1-Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";

2-Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë autoritetit të Komisionerit, në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21);

3-Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni27);

4-A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese.

Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi Proces-Verbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara, vëren se:

- Kontrolluesi, *Klinika-Gjinekologjike "URSULA"*, Tiranë, nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Komisionerit, sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale".

